



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.5.2023

Nr: 508

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË MEDIAS GJERMANE “DEUTCHE WELLE”, RADIO TELEVISIONI  
DUKAGJINI, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS  
14 MAJ 2023**

Sot në datën 12.5.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

**KËRKUES:** Media gjermane “Deutche Welle”, me seli në Bon, Gjermani dhe me përfaqësuese  
zj. Adelheid Feilcke;

Radio Televizion Dukagjini, me adresë Rruga “Gjergj Fishta”, Prishtinë dhe me  
drejtor z. Ermal Panduri;

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të Medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për  
organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi  
Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë  
27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit  
dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe  
të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe  
mediave”.

Data: 12.5.2023 Nr: 508  
Ora: 17:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të medias gjermane “Deutche Welle”, Radio Televizioni Dukagjini, për vëzhgimin e  
zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj  
2023”

## V Ë R E J:

Media Gjermane “Deutsche Welle” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 1 (një) gazetar si dhe zonë e vëzhgimit. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Media gjermane “Deutsche Welle” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Radio Televizion Dukagjini i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Radio Televizion Dukagjini është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

## V E N D O S :

1. Akreditimin e 1 (një) gazetari të Medias gjermane “Deutsche Welle” për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 2 (dy) gazetarëve të Radio Televizion Dukagjinit për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**